



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06
Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrori: Dr. Fidelma Donlon

Data: 12 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Njoftim për emërimin e mbrojtësit të Rexhep Selimit

me një shtojcë konfidenciale

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

1. Në pajtim me rregullën 26(1) të Rregullores¹, nëpërmjet këtij njoftimi Administratorja informon Gjykatësin e Procedurës Paraprake për emërimin e zotit Dejvid Jang si mbrojtës të zotit Rexhep Selimi.
2. Më datë 5 nëntor 2020, Administratorja caktoi zotin Robert Karls si mbrojtës kujdestar për zotin Selimi deri në emërimin ose në caktimin e mbrojtësit.²
3. Në paraqitjen e parë të zotit Selimi më datë 11 nëntor 2020, zoti Karls e informoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake se zoti Selimi do të kërkonte emërimin e zotit Jang si mbrojtës dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kërkoi Administratores parashtrimin brenda kësaj çështjeje të një njoftimi me të cilin ta informonte Gjykatësin e Procedurës Paraprake lidhur me vendimin e saj për këtë.³
4. Më datë 12 nëntor 2020, zoti Selimi i paraqiti Administratores, nëpërmjet shefit të Zyrës së Mbrojtjes, kërkesën për emërimin e zotit Jang si mbrojtës, si edhe aktin e përfaqësimit ku autorizon zotin Jang ta përfaqësojë përpara Dhomave të Specializuara.⁴
5. Zoti Jang është pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar në përputhje me rregullat 25(1) dhe 26(1) të Rregullores dhe me Direktivën për Mbrojtësit.⁵
6. Më datë 12 nëntor 2020, Administratorja e emëroi zotin Jang si mbrojtës të zotit Selimi në pajtim me pjesët 12 dhe 13 të Direktivës për Mbrojtësit.⁶

¹ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-03/Rev3/2020, ('Rregullorja'); *shih edhe* Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015, nenet 21(4), 21(5), 34(7) dhe 41(4)(b).

² Njoftim për pranimin e Rexhep Selimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2020-06/F00055, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³ *Shih* paraqitja e parë (seancë e hapur), KSC-BC-2020-06, 11 nëntor 2020, transkript paraprak f. 91, ll. 13-20.

⁴ *Shih* Shtojca 1.

⁵ *Shih* Direktivë për Mbrojtësit, KSC-BD-04, 6 nëntor 2017 ('Direktiva për Mbrojtësit'); Vendimi për pranimin në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, KSC/REG/DEF/0039, 2 maj 2018.

⁶ *Shih* Shtojca 1; *shih edhe* Direktiva për Mbrojtësit, pjesa 12, 13.

7. Ky njoftim parashtrohet me klasifikimin publik, ndërsa shtojca 1 parashtrohet me klasifikimin konfidencial në pajtim me rregullën 82(1)(b) dhe (3) të Rregullores, duke qenë se përmban të dhëna personale për zotin Selimi dhe për mbrojtësin, që janë të dhënat e kontaktit dhe numrat e pasaportës.

Numri i fjalëve (në origjinal): 350

/nënshkrimi/

Dr. Fidelma Donlon
Administratore

E enjte, më 12 nëntor 2020
Hagë, Holandë